VENDIM
Nr. 351, datë 28.12.2022

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË "KURUM INTERNATIONAL" SHA, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 213, SERIA PM13P, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 132, DATË 6.12.2011, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s DHE TRANSFERUAR ME VENDIMIN NR. 126, DATË 28.10.2013, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s TE SHOQËRIA "KURUM INTERNTIONAL" SHA, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-i "SHKOPET"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 10 pika 3 dhe nenit 15, pika 4 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016; neneve 15 dhe 19 pika 1 germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2116/11 prot., datë 23.12.2022 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës shoqërisë "Kurum International" sh.a., për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s te shoqëria "Kurum Interntional" sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i "Shkopet",

konstatoi se:

- Shoqëria "Kurum International" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2093 prot., datë 16.12.2022, ka përcjellë kërkesën për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike për HEC "Shkopet".

- Kërkesa për modifikim vjen për arsye se në maj 2023 kjo shoqëri ka programuar rehabilitimin e HEC "Shkopet", "optimizimi i operimit të turbinave", gjatë të cilit do të zëvendësohen disa nga pajisjet kryesore të centralit dhe do të instalohen pajisje të reja dhe do të ketë një shtesë kapaciteti prej 4 mw dhe fuqia nominale do të jetë Pn=28 mw.

- Me vendimet e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 132/2011 "Për licencimin e shoqërisë 'HEC Ulëz–Shkopet' sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et Ulëz dhe Shkopet", dhe nr. 136/2011, "Për licencimin e shoqërisë 'HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2' sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga 'HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2'", licencat që mbanin shoqëritë 'HEC Ulez – Shkopet' sh.p.k. dhe 'HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2' sh.p.k. janë transferuar te shoqëria "Kurum International" sh.a.

- HEC "Shkopet" është ndërtuar në vitin 1957 në lumin e Matit në qytetin e Burrelit – rrethi Dibër dhe me ligjin nr. 94/2013, datë 4.3.2013, "Për ratifikimin e kontratës së shitjes së 100% të aksioneve të shoqërisë "HEC Ulëz–Shkopet" sh.a. të lidhur ndërmjet METE-s (sot "MIE") dhe shoqërisë "Kurum International" sh.a...", është ratifikuar kontrata për shitjen e 100% të aksioneve nga shoqëria "HEC Ulëz–Shkopet" sh.a. te shoqëria "Kurum International" sh.a., duke kaluar "HEC Shkopet" në pronësi të "Kurum International" sh.a.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria "Kurum International" sh.a. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:

Neni 15, "Modifikimi i licencës", pika 4, germat "a", "b" dhe "d". Plotësuar.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se mungon dokumentacioni si vijon:

- Neni 15, "Modifikimi i licencës", pika 4;

- germa "c", shoqëria nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores.

- germa "e", shoqëria duhet të depozitonte dokumentin përkatës mbi miratimin/qëndrimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes së Mjedisit në lidhje me kapacitetin e ri të kërkuar për modifikim prej 28 mw.

- germa "f", shoqëria duhet të depozitonte miratimin/qëndrimin përkatës të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore në lidhje me kapacitetin e ri të kërkuar për modifikim prej 28 mw.

- germa “g”, shoqëria duhet të depozitonte në ERE qëndrimin/miratimin përkatës të Operatorit të Sistemit të Transmetimit në lidhje me kapacitetin e ri të kërkuar për modifikim prej 28 mw.

- Në kuadër të mosplotësimit nga Aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet mosfillimi i procedurës për këtë aplikim.

- Në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, date 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s tek shoqëria “Kurum International” sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet”, me kapacitet të instaluar 24 mw.

2. Nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti